

Kantoni Aargau

[Portret i shkurtër](#)

[Sistemi politik](#)

[Religjioni](#)

[Koha e lirë](#)

Portret i shkurtër

Aargau është një nga 26 kantonet (shtete anëtare) të Zvicrës. Krahasuar me numrin e banorëve, ky është kantoni i katërt më i madh. Tipike për Aargau është shumëllojshmëria rajonale e tij.

Numra dhe fakte

Kantoni Aargau ka më shumë se 700,000 banorë, nga të cilët pothuajse një çerek janë shtetas të huaj. Kantoni me sipërfaqe prej 1404 km² përfshin 11 rrethe dhe më shumë se 200 vendbanime (komuna). Kryeqyteti është Aarau. Gjuha zyrtare është gjermanishtja. Kantoni përbëhet nga shumë rajone të decentralizuara, secili me kryeqendren e vet. Rajonet kryesore janë Aarau, Badeni, Bruggi, Wohleni, Bremgarten, Zofingeni dhe Rheinfeldeni. Rajone të veçanta ndryshojnë në peizazh, kulturë dhe ekonomi.

Historia

Kantoni Aargau u themelua në vitin 1803. Territoret që u bashkuan në Aargau nga perandori francez Napoléon Bonaparte ishin shumë të ndryshme politikisht, konfesionalisht dhe ekonomikisht. Kjo ndjehet edhe sot. Deri rreth vitit 1900, bujqësia ishte shumë e rëndësishme për kantonin. Me industrializimin, kjo ndryshoi gradualisht. Megjithatë, edhe sot, kantoni Aargau është ende i ndikuar nga jeta rurale dhe ka një industri me korporata ndërkombëtare të mëdha dhe shumë ndërmarrje të vogla dhe mesme. Që nga Lufta e Dytë Botërore, shumë emigrantë janë vendosur në kanton, të cilët kanë dhënë një kontribut vendimtar në ekonomi dhe ende, edhe sot, po e japin.

Zakonet dhe traditat

Në rrethe dhe komuna të ndryshme të kantonit ka tradita dhe zakone të ndryshme. Nuk ekziston një zakon i njëjtë argauëz për shkak të diversitetit historik të kantonit. Në qytetet më të mëdha Aarau, Baden, Brugg, Lenzburg ose Zofingen, festat e të rinjëve në fillim të verës janë kulminacioni në kalendarin kulturor. Rrjedha e këtyre festave ka mbetur pothuajse e pandryshuar që prej shekujsh. Edhe Karnevali në dimër ka një vlerë të lartë në disa rajone. Në shumë fshatra dhe zona rurale ka zakone të frytshme në pranverë dhe festa të falenderimit të të korrave në vjeshtë. Këtyre iu shtohen edhe festat e ndryshme të krishtera.

Aargau -"Rüebliiland"

Aargau njihet si "Rüebliiland" (vendi i karotave). Nuk dihet saktësisht pse Aargau e ka marrë këtë emër, por nuk ka të bëjë fare me kulturën ose konsumin e karotave. Torta tipike e Aargau me karota (Rüebliorte) është shumë e njohur në gjithë Zvicrën. Në Aarau, një herë në vit mbahet një treg i madh karotash (Rüeblimarkt).

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

ola-aargau.ch/sq/kantoni-i-aargaut/portret-i-shkurt

Sistemi politik

Fuqia politike në Zvicër është e ndarë në tri rrafshe: federatë, kantone (shtete anëtare) dhe komuna. Zviceranet dhe zvicranët përmes votimeve mund të vendosin për ndryshime politike.

Konfederata Zvicërane

Shteti federativ zviceran ekziston që nga viti 1848. Kryeqyteti është Berni. Zvicra nuk formon unitet as etnik, as gjuhësor dhe as fetar. Meqenëse janë bashkuar vullnetarisht kultura të ndryshme, flitet për një komb vullnetar (Willensnation). Zvicra në politikën nderkombëtare është shtet neutral.

Federlizmi

Kantonet dhe komunat në Zvicër kanë autonomi të madhe, flitet për federalizëm. 26 kantonet dhe mbi 2000 komunat kanë struktura shtetërore plotësisht të zhvilluara. Kantoni Aargau e ka kushtetutën dhe qeverinë, parlamentin dhe gjykatat e veta. Kantonet ose komunat janë përgjegjëse për një numër të madh detyrash shtetërore. Për këtë arsye, për shembull, sistemi shkollor rregullohet ndryshe nga kantoni në kanton. Ndërkaq ligjet federale zbatohen në gjithë Zvicrën, kantonet i kanë ligjet e tyre që zbatohen vetëm brenda kantonit. Për të përballuar detyrat, kantonet dhe komunat, si edhe federata, mbledhin tatime.

Ndarja e pushteteve

Për ta parandaluar koncentrimin e pushtetit, fuqia shtetëror në Zvicër dhe në kantone është ndarë në tri pushtete të pavarura: legjislativi (pushteti ligjdhënës), ekzekutivi (pushteti ligjzbatues) dhe gjyqësori (pushteti gjyqësor). Në kantonin Aargau, këto detyra i marrin autoritetet vijuese:

- Legjislativi: Këshilli i Madh (Grosser Rat) (140 anëtarë, të zgjedhur nga populli çdo katër vjet)
- Ekzekutivi: Qeveria Kantonale (Regierungsrat) (5 anëtarë, të zgjedhur nga populli çdo katër vjet)
- Gjyqësor: Gjykata të ndryshme në nivele rrethesh dhe kantoni

Edhe komunitat e kanë legjislativin e tyre (Kuvendin Komunal ose Parlamentin) (Gemeindeversammlung, Parlament) dhe ekzekutivin (Këshillin e Qytetit apo Këshillin Bashkiak) (Stadtrat, Gemeinderat).

Në nivelin federal, legjislativi ka dy dhoma: Këshillin Kombëtar dhe Këshillin Shtetëror (National- und Ständerat). Qeveria kombëtare (7 anëtarë) quhet Bundesrat. Ekzistojnë gjithashtu gjykata të ndryshme në nivel kombëtar. Për shembull, vendimet e gjykatave kantonale mund të apelojnë në Gjykatën Supreme Federative si autoritet suprem.

Të drejtat demokratike

Zvicëranet dhe zvicëranët kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjedhen. Ata zgjedhin organet politike në nivel komunal, kantonial dhe federal dhe gjithashtu mund të kandidojnë vetë në zgjedhje. Përveç kësaj, qytetarët mund të mbajnë referendume për çështje politike në nivel komunal, kantonial dhe federal (demokracia e drejtpërdrejtë). Me nisma popullore, qytetarët mund të vënë në votim edhe shqetësimet e tyre. Të huajt që jetojnë në kantonin Aargau nuk kanë të drejtë të zgjedhin apo të zgjedhen. Ata mund t'i adresojnë shqetësimet e tyre politike me peticione drejtuar autoriteteve.

Të drejtat themelore

Parimet më të larta të të drejtave në Zvicër janë të përcaktuara në Kushtetutën Federale (Bundesverfassung). Në një pjesë të rëndësishme të Kushtetutës Federale janë të drejtat themelore, të cilat bazohen në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (EMRK). Ato mbrojnë ekzistencën njerëzore (p.sh. të drejtën për jetë, të drejtën për ndihmë në raste urgjente) dhe mbrojnë individët nga dhuna shtetërore ose grupet kundër shumicës. Ato garantojnë se askush nuk do të diskriminohet për shkak të origjinës, racës, religjionit, gjinisë ose orientimit seksual. Viktimat e diskriminimit racor marrin mbështetje dhe këshilla falas në kantonin Aargau. Liria e fesë, e mendimit dhe e shtypit mbisundon në Zvicër.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

ola-aargau.ch/sq/kantoni-i-aargaut/sistemi-politik

Religjioni

Zvicra tradicionalisht është vend i krishter. Sot në Zvicër jetojnë edhe shumë pjesëtarë të bashkësive tjera fetare. Liria fetare është e garantuar dhe shkollat shtetërore fetarisht janë neutrale.

Religjioni dhe shteti

Zvicrën tradicionalisht e karakterizon feja krishtere. Rregullimi i marrëdhënieve mes fesë dhe shtetit është përgjegjësi e kantoneve. Në shumicën e kantoneve gjermano-zvicërane, si edhe në kantonin e Aargaut, bashkësitë fetare të krishtera njihen si institucione publike-juridike (Kisha të shtetit, Landeskirchen). Kjo do të thotë se shteti atyre iu transferon disa të drejta. Konkretisht, ato munden, p.sh. prej pjestarëve të tyre të marrin tatim. Në kantonin Aargau Kisha Romake-Katolike, Kisha e Reformuar dhe Kisha Kristiane- Katolike janë kisha të shtetit.

Bashkësitë fetare në Kantonin Aargau

Krahas bashkësive fetare (kishave të shtetit) zyrtarisht në kantonin Aargau janë të njohura edhe bashkësi tjera të shumta fetare të besimeve të ndryshme. Shumica e banoreve dhe banorëve të Kantonit Aargau i përkasin një besimi të krishter. Në vitet e fundit edhe numri i muslimanëve është rritur. Gati një e pesta e banoreve dhe banorëve deklarojnë se nuk ndjejnë se i përkasin ndonjë besimi fetar.

Liria fetare

Kushtetuta zvicerane garanton lirinë fetare. Secili ka të drejtë ta ketë besimin e tij fetar, ta shprehë dhe përhapë atë besim. Askush nuk mund të jetë i detyruar t'i bashkohet një bashkësie fetare ose të marrë pjesë në veprimtari fetare. Njerëzit lejohen të mblidhen dhe të angazhohen në ritet dhe festimet fetare. Askush nuk guxon të jetë i diskriminuar për shkak të religjionit ose besimit të tij.

Religjioni dhe shkolla

Shkollimi i obligativ fetarisht është neutral. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se temat fetare nuk kanë vend në mësim. Bëhet dallimi midis dy llojeve të mësimin fetar: Mësimi konfesional religjioz i kishave vendore dhe mësimi fetar shkollor "Etika dhe religjionet". Në këtë fushë trajtohen tema dhe çështje fetare e etike që prekin të gjithë njerëzit. Në shkollën fillore dhe në vitin e parë të ciklit të lartë shkollor është lëndë e detyrueshme. Pjesëmarrja në mësimin konfesional fetar në kishat vendore është vullnetar. Bashkësitë tjera fetare ndonjëherë ofrojnë mundësi mësimdhënje jashtë shkollës për fëmijët e besimeve të tjera.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

ola-aargau.ch/sq/kantoni-i-aargaut/feja

Koha e lirë

Në kantonin Aargau ka mundësi të shumta atraktive për ta kaluar kohën e lirë. Një domethënie të madhe kanë shoqatat. Këto ofrojnë mundësi për të njohur njerëz tjerë.

Shoqatat

Shumë banorë të kantonit Aargau janë anëtarë të një shoqate (Verein). Ka shoqata për interesa nga më të ndryshmet. Shoqata sportive, kulturore dhe të tjera. Ka edhe në komuna më të vogla. Ato ofrojnë mundësi ideale për të hyrë në kontakt me njerëz të tjerë. Shumica e shoqatave janë të hapura për të gjithë. Informatat për shoqata mund të gjenden në faqen e internetit të komunës.

Ofertat për të rinjtë

Për të rinjtë në kantonin Aargau ka shumë oferta specifike për kalimin e kohës së lirë dhe njohje me bashkëmoshatarë tjerë. Në shumë komuna ka vendtakime dhe oferta të ndryshme për kohën e lirë. Ka përkujdesje për të rinjtë, ata mund t'i sjellin idetë e tyre dhe t'i zbatojnë projektet e tyre (Jugendarbeit). Ofertat zakonisht janë falas. Shoqatat rinore ofrojnë mundësi për të bërë aktivitete së bashku me bashkëmoshatarët e tyre dhe për t'u marrë me sport në natyrë. Bartës të ofertave janë shoqatat, komunat ose kishat e shtetit. Ofertat janë të hapura për të gjithë të rinjtë. Komuna ku banon jep informata të mëtejshme.

Ekskursionet dhe kultura

Kantoni i Aargaut ofronë mundësi të shumta për shëtitje dhe ofertë të pasur kulturore. Shumë qytete të vjetra historike, pallate dhe kështjella, lumenjt dhe liqejt si dhe banjat termale janë të famshme. Përveç kësaj ka edhe shumë rrugë të bukura shtegëtimi- dhe rrugë për biçikleta. Një numër i madh i muzeve ofrojnë ekspozita me tema të ndryshme. Në gjithë Zvicrën janë të njohura shtëpia e Artit (Kunsthau) Aargau dhe Stapferhaus në Lenzburg. Turizmi i Aargaut (Aargau Tourismus) informon për mundësitë e shëtitjeve dhe shfaqjet. Informatat për shfaqjet kulturore aktuale gjenden edhe në gazetatat lokale.

Puna vullnetare

Puna vullnetare (Freiwilligenarbeit) është kontribut i shoqërisë për njerëzit dhe ambientin e cila nuk paguhet. Detyra të shumta në parim merren prej vullnetarëve. Një pjesë e madhe e punës bëhet në shoqata. Kështu, njeriu mund të angazhohet në shoqatat për kulturë, sport, çështje sociale, arsim, për mbrojtjen e kafshëve dhe ambientit, shëndetësi dhe fusha të tjera. Informata për punën vullnetare dhe mundësitë e angazhimit japin agjensitë e specializuara për punë vullnetare Benevol, Caritas Aargau apo Kryqi i Kuq Zvicëran Aargau (SRK). Në shumicën e rajoneve të kantonit, zyrat koordinuese për punë vullnetare në sektorin e azilit dhe refugjatëve (KFA) organizojnë punë vullnetare në sektorin e azilit.

Sporti / Kultura / Arsimi

Me kartën - Kulturlegji, nerëzit me pak para përfitojnë ulje në aktivitete sportive, kulturore dhe edukative. Kjo kartë mund të kërkohet në Caritas. Caritasi informon lidhur me këtë dhe verifikon nëse keni të drejtë të keni Kulturlegji.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

ola-aargau.ch/sq/kantoni-i-aargaut/koha-e-lire